

Data 12/09/2024

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHERBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit”
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (cpv):** 50112000-3
- **Vlera e fondit limit:** 7,500,800 (shtatë milion e pesëqind mijë e teteqind) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ALBCONTROL ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: *kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 OE duhet të paraqesë vetëdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, ku të deklarojë se ka në stafin e tij të paktën 5 punonjës të specializuar, dhe punësuar, në momentin e deklarimit dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës për profilet si më poshtë:

- 1 (një) **inxhinier mekanik**
- 1 (një) **specialist mekanik**
- 1 (një) **specialist-motorist**

- 1 (një) **specialist-elektroaut**
- 1 (një) **specialist-pompist**
- Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë:
 - për **inxhinierin mekanik**
 - Diplomën përkatëse,
 - Dëshmi Aftësie Profesionale, në fushën e aktivitetit të autoriparimit, në cilësinë e përgjegjësitet teknik të subjektit.
 - për **specialistin mekanik**
 - Certifikatë/dëshmi/diplomë kualifikimi, lëshuar nga shkolla e mesme profesionale apo institucione jo-publike të akredituara.
 - për **specialistin-motorist**
 - Dëshmi/Certifikatë kualifikimi
 - për **specialistin-elektroaut**
 - Dëshmi/Certifikatë kualifikimi
 - për **specialist-pompist**
 - Dëshmi/Certifikatë kualifikimi
- Për gjithë personelin teknik të lartpërmendur ofertuesi duhet të paraqesë kontratat e punës respektive, konform akteve ligjore. Kontratat e punës duhet të kenë një afat vlefshmërie përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Kërkesa e AK që OE duhet të paraqesë vetëdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se se ka në stafin e tij të paktën 5 punonjës të specializuar, dhe punësuar, në momentin e deklarimit dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës për profilet inxhinier mekanik, mekanik, specialist motorrist, specialist elektroaut, dhe specialist pompist është në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh zërat përkatës të shërbimeve për secilin automjet si dhe kualifikimin e duhur profesional që duhet të kenë specialistët që do të kryejnë diagnostikimin dhe riparimin e tyre.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2021,2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20 % e fondit limit.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Duke marrë në konsideratë kontratën objekt prokurimi është menduar se vlera e kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar me kontratat e ngjashme të jetë 20% e vlerës kufi të përcaktuar në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka sigurinë dhe besueshmërinë që operatori ekonomik ofertues do realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikatat qe vertetojne perputhshmerine me standardet:

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë brenda kohës së vlefshmerise.
- **ISO 14001: 2015**, Sistemin e Manaxhimit të Mjedisit ose ekuivalent e cila duhet të jetë brenda kohës së vlefshmerise.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalente me to.

Argumentim: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001:2015-Menaxhimi i cilësisë i certifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit. Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoriteteve në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në teresi.

ISO 14001: 2015 - Duke qënë se disa nga zërat e preventivit janë të lidhur dhe kanë ndikim në mjedisin, Autoriteti kontraktor (AK) kërkon këtë certifikatë, të lëshuara nga organe të pavarura, për të vërtetuar pajtueshmërinë e operatorit ekonomik ofertuesi me standardet e kërkuara, si edhe për të pasur garanci që shërbimet (furnizim vendosje) që do të kryhen do të jenë të një cilësie të lartë dhe brenda çdo kushti ndërkombëtar.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Licencën e kategorisë VII.3.B.1**, për veprimtarinë “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” në QKL **ne lidhje me objektin e prokurimit** .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe në zbatim të **Udhëzimit të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016**, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.4 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për realizimin e objektit të prokurimit në servis për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) paisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergences) së rrotave të mjetit .
- b) paisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete;
- c) paisje për kontrollin dhe komprimimin e gazit të A/C;
- d) paisje urë ngritese për automjetet;
- e) paisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;
- f) paisje për furnizimin me alkol te sistemit të frenimit;
- g) paisje për kontrollin të sistemit të ushqimit.

Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Deklarate nga operatori ekonomik që disponon këto mjete gjate gjithë kohezgjatjes së kontratës shoqeruar me fotot perkatese të të gjitha pajisjeve.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku të specifikohen pikat e mësipërme, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi : *Kërkesa që OE duhet të duhet të paraqesë një deklaratë për disponimin e paisjeve shoqeruar me foto është vendosur duke patur parasysh zërat e shërbimeve të kërkuara në specifikimet teknike.*

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara në zërat e riparimit të kërkuara në specifikimet teknike.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një ambient pune (servis) të përshtatshme brenda territorit të Bashkive respektive: Tiranë, Kamëz, Vorë. Për këtë, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë/ qiramarrjen si më poshtë:

a. Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

b. Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje (e vlefshme).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të nenit 77, Kreu XII të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 8, nenit 40, Kreu V të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Në mënyrë që të vërtetohet që operatorët ekonomikë disponojnë hapësirën e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre gjykojmë se është e nevojshme demonstrimi i këtij fakti përmes paraqitjes së një dokumenti i cili vërteton pronësinë, huapërdorjen, qiramarrjen referuar dispozitave përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve është vlerësuar e domosdoshme/nevojshme që operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtrojnë aktivitetin e tyre me qëllim realizimin e shërbimeve objekt prokurimi.

Ky kriter është vendosur në mënyrë që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme organizative, për të zbatuar dhe për të përmbushur kontratën në përputhje me specifikimet dhe standardet e kërkuara nga Autoriteti kontraktor dhe nisur nga shumëllojshmëria e mjeteve, specifikat e veçanta të tyre dhe numri i mjeteve për mirëmbajtje.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon **1 (një) automjet karrotrec** për transportin e automjeteve në rast defektsh, ne pronësi ose ne përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon 1 (një) automjet karrotrec, ne pronësi ose ne përdorim sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- çertifikatë e kontrollit teknik

Në rastin kur automjeti është me qera, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjete dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa që OE duhet të deklarojë se dispon 1 (një) automjet karrotrec për transportin e automjeteve në rast defektsh, për të cilin duhet që për periudhën e zbatimit të kontratës, është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës duke patur parasysh se për kryerjen e shërbimeve të kërkuara për automjetet, secili prej tyre duhet të shkojë pranë “pikës së servisit” të kontraktorit. Duke qene se të gjitha automjetet e kryejnë aktivitetin e tyre brenda qytetit të Tiranës, ku ato mund të bëjnë defekte të mundshme.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklaroje se pjesët e këmbimit që do të perdoren duhet të ofrohen të reja, prodhim sipas CE dhe me garanci jo me pak se 1 vit nga data e montimit (furnizim-vendosje).

Argumentimi: Në bazë nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kane aftësitë për të realizuar me sukses dhe sipas kriterëve riparimin e automjeteve.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë që merr persiper riparimin dhe mirembajtje (Difekte)te automjeteve që janë në shërbim 24/24 ore në çdo vend që ndodh difekti, gjatë gjithë periudhës së zbatimit kontratës

Argumentimi: Në bazë nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kane aftësitë për të realizuar me sukses dhe sipas kriterëve riparimin e automjeteve.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve

NJESIA E PROKURIMIT

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.